

UDHËZIM
Nr. 9, datë 29.5.2023

**PËR LLOJIN DHE PERIODICITETIN E INFORMACIONIT QË VIHET NË
DISPOZICION NGA AGJENCIA PËR EFIÇENCËN E ENERGJISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 15, të ligjit nr. 124/2015, “Për efiçencën e energjisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është informimi dhe rritja e kapaciteteve të palëve të interesuara, lidhur me mekanizmat e efiçencës së energjisë, metodat dhe praktikrat e ndryshme që shërbejnë për të rritur performancën e energjisë, përmes informimit të tyre të vazhdueshëm dhe prezantimit të praktikave më të mira të disponueshme për arritjen e objektivit kombëtar të kursimit të energjisë.

2. Agjencia për Efiçencën e Energjisë, (në vijim AEE) është përgjegjëse për informimin në mënyrë periodike të:

- a) konsumatorëve fundorë të energjisë;
- b) konsumatorëve të mëdhenj të energjisë;
- c) institucioneve të qeverisjes qendrore dhe vendore;
- d) shoqërive publike.

3. Për secilën palë të interesuar të përmendur në pikën 2, AEE përgatit një informacion me praktikrat më të mira mbi mekanizmat për rritjen e efiçencës së energjisë dhe metodat për rritjen e performancës së energjisë sipas aktiviteteve respektive, mundësive reale për përmirësim, si dhe përfitimet që mund të arrihen prej zbatimit të masave të efiçencës së energjisë, çdo vit, para datës 31 mars dhe publikon çdo informacion në faqen e saj zyrtare të internetit.

4. Informacioni i vendosur në dispozicion nga AEE, i cili duhet të jetë specifik për secilën palë të interesuar dhe në përputhje me aktivitetin e tyre, përditësohet çdo vit me përmbajtje të reja.

5. Më qëllim promovimin e efiçencës së energjisë dhe ndërgjegjësimin e palëve të interesuara, AEE duhet që të paktën një herë në vit të:

- a) marrë pjesë në panairë ose ekspozita të energjisë;
- b) organizojë seminare dhe fushata informuese në përputhje me aktivitetin e saj.

6. AEE publikon, në faqen e saj zyrtare të internetit, informacione mbi mekanizmat financiar dhe ligjor të efiçencës së energjisë duke përfshirë:

- a) listën e të gjithë institucioneve financiare dhe bankave të nivelit të dytë që ofrojnë mbështetje për zbatimin e masave të efiçencës së energjisë;
- b) listën e të gjithë legjislacionit të miratuar për efiçencën e energjisë;
- c) informacion mbi lehtësitë fiskale të ofruara nga programe të ndryshme buxhetore;
- d) informacion për përfitimin e granteve të ofruara nga organe të qeverisjes qendrore dhe vendore në nivel kombëtar, duke specifikuar dhe procedurën e aplikimit për përfitimin e tyre.

7. Para datës 30 nëntor të çdo viti, AEE publikon në faqen e saj zyrtare të internetit datat dhe agjendën përkatëse mbi trajnimet që do të organizojë gjatë vitit pasardhës për:

- a) menaxherët e energjisë;
- b) audituesit e energjisë në ndërtesa;
- c) audituesit e energjisë në industri;
- d) audituesit e energjisë në transport;
- e) punonjësit e institucioneve publike;
- f) palë të tjera të interesuara.

8. AEE raporton në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për çdo vit, para datës 30 shtator, të gjithë informacionin e vënë në dispozicion dhe aktivitetet që ka ndërmarrë për zbatimin e këtij udhëzimi.

9. Ngarkohet Agjencia për Eficiency e Energjisë për zbatimin e këtij udhëzimi.
10. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVËNDËSKRYEMINISTËR DHE
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku